

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika® Poxitar® F

VESHJE KOMBINIMI EPOKSIDI - VAJI ANTRACENI  
PËR APLIKIME TË RËNDA MBI ÇELIK DHE BETON



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Veshje rezistente me 2 përbërës dhe me përmbajtje të ulët tretësi me bazë kombinimi epoksidi-vaj antraceni dhe lëndë mbushëse minerale.  
Përmbajtje e ulët tretësi sipas Udhëzimit të Veshjeve Mbrojtëse të Lidhjes Gjermane të Industrisë së Bojërave (VDL-RL 04).

### PËRDORIMET

Sika® Poxitar® F duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.  
Veshje mbrojtëse për beton dhe çelik, për struktura të mbuluara me dhë, p.sh. sistemet e ujërave të ndotur, industria kimike, etj.  
Është gjithashtu i përshtatshëm kudo që aplikimi mbi beton të lagësht është i pashmangshëm.  
Nuk është i përshtatshëm për sipërfaqet në kontakt me ujin e pijshëm, mjedise me kafshë shtëpiake, stalla, etj.

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

Pas tharjes së plotë Sika® Poxitar® F ka:

- Rezistencë ndaj sforcimeve të mëdha, me rendiment të lartë
- Rezistencë ndaj abrazionit dhe tronditjeve
- Rezistencë të shkëlqyer ndaj ujit dhe kimikateve

Sika® Poxitar® F mund të ekspozohet ndaj ujit menjëherë pas aplikimit. Por, duhet patur në konsideratë se tretësit depërtojnë në ujë, gjë e cila shkakton kontaminim të përkohshëm. Pra, ekspozimi i menjëhershëm ndaj ujit duhet të konsiderohet vetëm në raste të veçanta dhe pas konsultimit me autoritetet për mbrojtjen e mjedisit.

### MIRATIME / STANDARDE

- Veshje me bazë rrëshire epokside për mbrojtje betoni sipas EN 1504-2:2004, DOP, me markë CE.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	Sika® Poxitar® F	enë 35 kg and 17 kg net.
	Sika® Thinner S	25 l, 10 l dhe 3 l
	SikaCor® Cleaner	160 l dhe 25 l
Paraqitja / Ngjyra	e zezë, e kuqe	
Jetëgjatësia	1 vit	
Kushtet e magazinimit	Në ambalazhin origjinal dhe të mbyllur, në mjedis të freskët dhe të thatë.	
Dendësia	~1.8 kg/l	
Përmbajtja e substancave të ngurta	~87 % për vëllim ~96 % për peshë	

## TË DHËNA TEKNIKE

<b>Rezistenca kimike</b>	Rezistencë ndaj ujit, ujit të detit, ujërave të ndotur, acideve dhe alkaleve të holluara, kripërave neutrale, vajrave mineralë dhe karburanteve, grasos, detergjentëve, etj. Nuk ka rezistencë ndaj hidrokarburëve-benzeni dhe ziftit.
<b>Rezistenca termike</b>	Nxehtësi e thatë deri në ~ +100°C Nxehtësi e lagësht dhe ujë i ngrohtë deri në ~ +60°C Ekspozim afatshkurtër deri në ~ +80°C Nuk ka rezistencë ndaj ujit të ngrohtë në diferencë të madhe të gradientit të temperaturave!

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

<b>Sistemet</b>	<b>Betoni:</b> 2 - 3 x Sika® Poxitar® F Veshja e 1-rë të hollëhet me max. 5% për peshë Sika® Thinner S, Veshja e 2-të e paholluar.  <b>Çeliku:</b> 2 - 3 x Sika® Poxitar® F Preferohet alternimi i ngjyrave. Në rast ekspozimi të rëndë mekanik, rekomandohet lyerja me prajmerin SikaCor® Zinc R.
-----------------	--

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

<b>Raporti i përzierjes</b>	Përbërësit A : B Për peshë 85 : 15
<b>Holluesi</b>	Sika® Thinner S, holloni materialin vetëm nëse kërkohet. Nëse nevojitet, mund të shtohet max. 5% Sika® Thinner S për të adaptuar viskozitetin. Në këtë rast nuk është i mundur ekspozimi i menjëhershëm ndaj ujit. Nëse është e nevojshme, përbërësit e materialit mund të zbuten.
<b>Konsumimi</b>	Konsumimi / mbulimi teorik i materialit pa humbje, për trashësi mesatare cipe: Trashësia e cipës së thatë 150 µm Trashësia e cipës së njomë 175 µm Konsumimi 0.310 kg/m <sup>2</sup> Konsumimi 3.25 m <sup>2</sup> /kg
<b>Temperatura e produktit</b>	Min. + 5°C
<b>Lagështia relative e ajrit</b>	Max. 85 %, me përjashtim rastet kur temperatura e sipërfaqes është ndjeshëm më e lartë sesa temperatura e pikës së vesës, duhet të jetë të paktën 3 K mbi pikën e vesës.  Në kushte të pafavorshme, p.sh. ndikimi i lagështisë së lartë të ajrit tek veshja e freskët, mund të ndodhin dëmtime të sipërfaqes (çngjyrosje kafe) dhe ka mundësi të ndodhë pak shpetëzim. Megjithatë, kjo gjë nuk ndikon mbi cilësinë.
<b>Temperatura e sipërfaqes</b>	Min. + 5°C
<b>Koha e punueshmërisë</b>	Në + 20°C ~1.5 orë

	Koha min. e pritjes	Koha max. e pritjes
Në + 5°C pas	36 orë	96 orë
Në + 10°C pas	30 orë	72 orë
Në + 15°C pas	24 orë	60 orë
Në + 20°C pas	12 orë	48 orë
Në + 25°C pas	8 orë	36 orë
Në + 30°C pas	6 orë	24 orë

Nëse këto kohë maksimale nuk mund të zbatohen, sipërfaqja duhet të aktivizohet me pastrim me rrymë rëre për të shmangur problemet e ngjitjes së shtresave me njëra-tjetrën.

Përpara aplikimit të veshjes vijuese, nevojitet një pastrim i plotë nga pluhuri.

Midis SikaCor® Zinc R dhe Sika® Poxitar® F:  
24 orë në + 20°C (lexo skedën teknike).

## Koha e tharjes

### Koha e tharjes përfundimtare

Në +20°C dhe me ventilim të mirë, tharja përfundimtare arrihet pas ~ 8-10 ditësh.

Tharja ndodh edhe në temperatura të ulëta - nën +10°C - por zgjat më shumë.

Tharja mund të ndodhë gjithashtu edhe nën ujë.

## UDHËZIME APLIKIMI

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

#### Betoni:

Solid dhe me strukturë të dendur, pa kore çimentoje, pluhur, grimca të lira dhe të shkrifëta dhe kontaminues të tjerë. Përmbajtja e lagështisë së betonit max. 8%. Pastrimi me rrymë rëre shton ndërkapjen. Kjo është tepër e rëndësishme në rast ekspozimi nën ujë. Vrimat dhe zgavrat e mëdha, etj. duhet të nivelohen me p.sh. Icoment®-520 Mortar ose Sika Poxitar® SW Mortar.

### PËRGATITJA E SIPËRFAQES

#### Celiku:

Pastrim me rrymë rëre deri Sa 2½ sipas ISO 12944-4. Pa pislëqe, vaj dhe graso. Thellësia mesatare e ashpërsisë Rz ≥ 50 mikron

### PËRZIERJA

Përzieri përbërësin A plotësisht me një mikser elektrik (filloni ngadalë, pastaj shtoni shpejtësinë deri në ~300 rpm). Shtoni me kujdes përbërësin B dhe përzieri të dy përbërësit plotësisht (anët dhe fundin e enës). Përzieri për të paktën 3 min. derisa të arrihet një miksi homogjen. Hidheni materialin e përzierë brenda një ene të pastër dhe përzieri sërish për pak siç përshkruhet më sipër. Gjatë përzierjes dhe përdorimit të materialit mbani gjithmonë veshur syze mbrojtëse, doreza të përshtatshme dhe veshje të tjera mbrojtëse.

### APLIKIMI

Metoda e aplikimit ka efekt madhor në arritjen e trashësisë dhe paraqitjes së njëtrajtshme. Aplikimi me spërkatje jep rezultatet më të mira. Trashësia e treguar e cipës së thatë arrihet me lehtësi me spërkatje pa ajër. Shtimi i tretësve redukton rezistencën ndaj varjes

dhe trashësinë e cipës së thatë. Në rast aplikimi me rul ose furçë, mund të nevojiten aplikime shtesë për të arritur trashësinë e kërkuar të veshjes, në varësi të llojit të konstruksionit, kushteve në kantier, ngjyrës, etj. Përpara aplikimeve në shkallë të madhe, mund të jetë i dobishëm një aplikim testues në kantier për të siguruar se metoda e përzgjedhur e aplikimit do të japë rezultatet e kërkuara.

#### Me furçë ose rul

#### Spërkatje pa ajër:

- Presion min. 150 bar
- Diametri i tubave min. 10 mm (¾ inch)
- Përmasa e majës 0.53 - 0.66 mm (0.021 - 0.026 inch)
- Këndi i spërkatjes 40° - 80°

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

SikaCor® Cleaner

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

### KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika® Poxitar® F  
Shtator 2019, Botimi 05.01  
020602000120000003

SikaPoxitarF-sq-AL-(09-2019)-5-1.pdf

